

RELACION I PROJEKTIT
ARKITEKTONIK

**“Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare
"Ismail Klosi" Ballsh dhe i terreneve
sportive në shkollat e qytetit të
Ballshit”**

AUTORITETI KONTRAKTOR:

BASHKIA

MALLAKASTËR

PROJEKTUES:

BOE Boe 2h studio &
Sirealb shpk

Perfaqesues 2H Studio

Ing.Levend Harizi

Nr. License: N.7185/5

SHKURT 2025

Përmbajtja:

- **Të përgjithshme;**
- **Objektivi;**
- **Qëllimi i punës;**
- **Mbështetja ligjore e teknike;**
- **Koncepti i projektit.**

Të përgjithshme:

Objekti që do të ndërtohet është shkollë 9-vjeçare "Ismail Klosi" Ballsh, në Bashkinë Mallakastër.

Shkolla ndodhet e pozicionuar në qendër të qytetit të Ballshit.

Shkolla do të ofrojë sipas klasifikimit ndërkombëtar standarte të arsimit, nivelet arsimore dhe arkitektonike me kodet:

Kodi "0"- Arsimit parashkollor;

Kodi "1"- Arsimit fillor; (Klasat 1-5)

Kodi "2"- Arsimit mesëm i ulët; (Klasat 6-9)

Shkolla do të ketë 240 nxënës në nivelet arsimore të mësipërme si dhe stafin e arsimtarëve dhe administratorëve të saj.

Objektivi:

Objektivi i projektit është hartimi i projektit të zbatimit për ndërtimin e shkollës në parametrat optimal dhe saktësime teknike me standarte të projektimit dhe zbatimit të objekteve arsimore të niveleve bashkohore.

Qëllimi i punës:

Projekti i zbatimit ka për qëllim përshtatjen, saktësimin, zbërthimin dhe detajimin e të gjithë elementëve ndërtimor arkitektonik, konstruktiv, instalimeve elektrike dhe mekanike, sipas dokumentave të projekt idesë përfundimtare dhe standarteve të projektimit dhe zbatimit si dhe brenda afateve të përcaktuara në Kontratë/Marrveshjen kuadër.

Mbështetja ligjore e teknike:

Projekti i zbatimit mbështetet në:

Ligji nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

VKM Nr.68 datë 15.02.2001 "Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të punimeve të ndërtimit"

VKM Nr. 319 datë 12.04.2017 "Për miratimin e Standarteve të Projektimit të Shkollave"

Analizës ekonomike të kostos së projektit duke u mbështetur në vizatimet dhe terrenin dhe duke përdorur cmimet e miratuara me V.K.M.

Pozicionimi

Shkolla 9-vjeçare "Ismail Klosi" është e pozicionuar në qendër të qytetit të Ballshit.

Shkolla ekzistuese ka një sipërfaqe të shfrytëzueshme rreth 1500 m² dhe është godinë 3-katëshe, me një hyrje në anën lindore. Struktura mbajtëse e shkollës është konceptuar me mure tulle me trashësi 25 cm. Bazuar në kushtet teknike të periudhës kur është ndërtuar, ajo është perforcuar me kollona antisizmike betonarme me permasa 25x25cm.

Në projektin e zbatimit ruhen të njëjtët parametra urban si në Projekt Idenë Përfundimtare

Kondicione Zhvillimi


Sipërfaqe e godinës	1500 m ²
Lartesi maksimale e Objektivit	11 m
Lartesia e Pergjithshme nga sistemimet:	11.6 m
Numri maksimal i Kateve	3 kate

KONCEPTI I PROJEKTIT

Hapësira Urbane

Hyrja në oborrin e shkollës bëhet pa shkallëzime e orientuar për hyrjen e shkollës gjithashtu është e orientuar drejt pandusit me pjerrësi 5% dhe gjerësi 1.3m për personat me aftësi të kufizuar, me sinjalizim të dukshëm dhe të vazhdueshëm. Oborri, trotuaret dhe pandusi do të jetë të shtruar me material jo të rreshqitshëm, pa pengesa për një lëvizje sa më të lehtë.

Të gjitha kalimet nëpër fushat e lojërave dhe fushat sportive janë të projektuara me platforma ose pa pengesa sa herë që një gjë e tillë është e nevojshme.




Për në objekt nga muri rrethues do të këtë një hyrje që drejton për në ambjentet e shkollës si dhe për në ambjentin e klasave parashkollore. Ambjenti parashkollor funksionon më vete nga ambjentet e tjera të shkollës, pra është i ndarë.

Përpara ambjentit të nivelit parashkollor ndodhet edhe këndi i lojrave dhe i rekreacionit lehtësisht i arritshëm për këtë grup moshë.

Aktualisht do të kete dy oborre, ai kryesor në hyrje dhe ai në pjesën e mbrapme ku ndodhet fusha e sportit. Në të dy oborret shkolla dhe ambjenti parashkollor komunikojnë me shkallë dhe panduse.

Kemi nje sistemim te ri te dy oborreve, me sheshe te shtruara me pllaka dekorative dhe me ambjente te jashtme sportive. Në të dy oborret do të këtë hapsira të gjelbërta me lulishte te mbjella me peme lule e bar, ambjente shlodhëse me stola, për pushim dhe për zhvillimin e aktiviteteve apo dhe orëve mësimore që kryhen në natyre.



Fusha e sporteve me dorë dhe ajo e futbollit do të jenë të organizuara dhe të vendosura në skajin verilindor të oborrit për të minimizuar zhurmat.

Koncepti i projektit arkitektonik, të volumit dhe fasadave për Objektivin Arsimor, është përcaktuar kryesisht në Projekt Idenë Përfundimtare, dhe ka tipologjinë e kategorisë së këtyre objekteve me volume të pastra dhe te lexueshme dhe ngjyra të forta. Ndërtesat janë estetike, me një formë të thjeshtë dhe materiale bashkëkohore. Por për t'ju përshtatur si terrenit, skemave konstruktive të përfutuara nga llogaritjet si dhe një funksionaliteti më të mirë janë kryer përshtatjet e nevojshme.


Objekti: Shkolla përbehet nga një godine 3 kate dhe palestra. Duke qenë se të dy korpuset janë në vazhdimësi të njeri-tjetrit, hyrja kryesore është përqendruar në objektin qendror, e dallueshme nga porta kryesore.

Në objektin 3 katësh kemi vetëm 24 klasa me kapacitet 24 nxënës. Ngjitur me të kemi palestrën. Në godine ka salla si: laborator të gjuhëve të huaja dhe informatikës, sallë leximi, laborator fizike, si dhe sallën e mësuesve, zyrën e drejtorit si dhe ambient teknik.

Ambjentet sanitare: Të pozicionuara dhe orientuara nga veri perndimi në çdo kat dhe lehtësisht të aksesueshme nga të gjitha klasat. Në katin përdhe lehtësisht i aksesueshëm është dhe ambienti sanitar për personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu në këtë kat janë edhe ambientet e zhveshjes dhe dusheve të palestrës.

Zona sportive: përbëhet nga palestra e brendëshme me standart për lojra me dore e shtruar me parket, ajrosur dhe ndriçuar, edhe me dritë natyrale nëpërmjet dritareve nga ana veriore dhe lindore të vendosura në lartësi.

Veshja e jashtme e objektit: Shkolla do të jetë e veshur me system kapotë me shtresën e jashtëme suva grafiato. Kjo do te permiresoje izolimin termik ne ambientet e brendshme dhe ruajtjen e energjise. Gjithashtu do te perdoren stuko te ndryshme ne funksion te propozimit arkitektonik. Do te perdoret suva ne ngjyra te ndryshme për tju përshtatur karakterit fëmënor.



Mbulesa e sipërme si dhe veshjet anësore të propozuara me sistemin kapotë, i japin objektit aftësi izolimi termik dhe efikasë të lartë energjie. Hidroizolimi do të sigurohet nga membranë në të gjithë sipërfaqen e mbulimit.

Të dhëna mbi ambjentet e shfrytëzueshme të Shkolles:

- 9 Klasa me nga 24 nxenes, prej rreth 38 m²
- 1 Laborator Fizike, 39.4 m²
- 1 Laborator Biologjie, 36.7 m²
- 1 Laborator Kimie, 37 m²
- 1 Laborator Informatike/Gjuhë të huaja 39.8m²
- 1 Laborator Pune me Dru, 21 m²
- 1 Palestër Fiskulture, 263.4 m²
- 1 Salle Mësuesish, 39.2 m²
- 1 Ambjent për Mësues, 17.3 m²
- Hapësira për shumë qëllime + dhomë audio, 48.8m²
- Drejtoria, 21 m²
- Zyra e nën/drejtorit, 17 m²
- Kabinet Psikologu, 18 m²
- Kabinet Dentisti/Mjeku, 16.3m²
- 6 nyje sanitare për vajza, 7.3 m²
- 6 nyje sanitare për djem, 7.3m²
- 1 nyje sanitare PAK, 4.5 m²
- 2 nyje sanitare staf, 7.3 m²
- 1 nyje sanitare/ 1 dush dhe dhoma garderobe për vajza, 10.5 m²
- 1 nyje sanitare/ 1 dush dhe dhoma garderobe për djem, 10.5 m²
- Ambjente për Parashkollor, 45.4 m²
- 1 Ambjent për Persona me Aftesi Ndryshe, 8.4m²
- 1 Ambjent për personelin ndihmës, 8.7 m²
- 1 Ambjent Teknik, 18.4 m²

Tarraca: Mbulesa e shkollës është zgjidhur me çati të re. Për shkarkimet e ujrave të shiut kemi piletat dhe tubat e shkarkimit që vijnë në fasadë dhe shkarkojnë në pusetat e vendosura në trotuarin rreth shkollës.

Shtresat e pllakave: Pllakat e dyschemesë janë parashikuar të njëjta për të unifikuar pamjen e shkollës. Në katin përdhe është parashikuar në dyscheme një shtresë hidroizoluese për mbrojtjen e objektit nga ujërat nëntokësore si edhe një shtresë niveluese me stirobeton për termoizolim.

Dyer, Dritare: Dyert do të jenë druri cilesi e pare. Ato propozohet të hapen nga jashtë, në rast evakuimi, që lejon hapjen e dyerve pa cenuar levizjen e lirë në korridore. Dritaret propozohen d/alumini plastik dopio xham, duke siguruar izolim termik të objektit.

Ambientet Sanitare: Janë propozuar në fund të korridorit për nevojat e palestrës së bashku me garderobën. Gjithashtu në katin e pare është parashikuar nyja sanitare për PAK.

Objekti i Kaldajës: Pozicionuar në shpinë të objektit, propozohet me një strukturë me kolona prej beton-arme dhe muraturë, duke respektuar të gjitha kushtet teknike për objekte të kësaj kategorie, në respekt të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe agjentëve atmosferikë. Trajtimi i fasadave të jashtme për kaldajën do të realizohet me të njëjtat karakteristika arkitektonike si edhe objekti i shkollës, për vijueshmëri dhe uniformitet të pamjes së jashtme. Ky objekt do të ketë dy dritare me grila metalike si dhe një portë me përmasa për objekte të tilla dhe material metalik.

PROJEKTUES:

**BOE Boe 2h studio & Sirealb
shpk**

Perfaqesues 2H Studio

Ing.Levend Harizi

Nr. License: N.7185/5